



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 12530/prot.

Tiranë, më 17.10 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.708, datë 08.07.2003.

SHOQËRISË “KARAJ” SH.P.K
Lagjia nr.4, Ndërtesa Private Një Katëshe, Ngjitur me Repartin Ushtarak,
Krujë, Qarku Durrës.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Karaj” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.708, datë 08.07.2003, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Pengile”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.8141 prot., datë 09.10.2018 protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.12530 prot, datë 09.10.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.708, datë 08.07.2003, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Pengile”, Krujë, për arsye nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit të mjedisit, për vitet 2011 – 2013, siç është përcaktuar në nenin 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kjo leje është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e**

procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.708, datë 08.07.2003, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Pengile”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.708, datë 08.07.2003, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Pengile”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

